



---

**Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +  
në Norwegian University of Science and Technology (NTNU), Norvegji.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Energjitikës, në University of Science and Technology (NTNU), Norvegji.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- **Master shkencor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master shkencor, "Menaxhim Energjie", në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Energjitikës.

**Kohëzgjatja e bursave dhe numri total i studentëve:**

- Master shkencor, një periudhë 4 mujore, gusht – dhjetor 2021, 6 studentë.
- Master shkencor, dy periudha 4 mujore, gusht – dhjetor 2021 dhe janar – maj 2022, 3 studentë.

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master shkencor:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*

\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën, duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni



**Key Action 1**  
**– Mobility for learners and staff –**

në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Science and Technology (NTNU, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

*Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Projektet.*

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

**Afati për aplikim për studentët: deri më 20 shkurt 2021**

Aplikimi kryhet pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Të interesuarit mund të drejtohen pranë Departamentit të Energjitikës, për të dorëzuar dokumentacionin përkatës. (Kontakti Prof. Asoc. Majlinda ALCANI, email: [malcani@fim.edu.al](mailto:malcani@fim.edu.al))

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit mund të kontaktoni në email: [zyraekarrieres@upt.al](mailto:zyraekarrieres@upt.al)